



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 905/3 Prot.

Tiranë, më 30.12.2020

**V E N D I M**

Nr.228, datë 30.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 13337, datë 15.7.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 905 prot., datë 4.12.2020, nga nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, është ngritur pretendimi se, transferimi i tij i përkohshëm për nevoja të institucionit, fillimisht në pozicionin “Doganier, Sektori Doganor Ballsh”, Dega Doganore Fier, dhe më pas në pozicionin “Doganier, Sektori Operacional Terminal”, po në Degën Doganore Fier, është në tejkalim të afatit 6-mujor që përcakton ligji në rastin e transferimit të përkohshëm, prandaj ai duhet të kthehet në vendin e punës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që: Në kuadër të implementimit të strukturës së fundit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njësia përgjegjëse (DAP), pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, ndërmjet të tjerave, me aktin nr. 5230, datë 11.9.2019, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër”, pranë DPD dhe mbi këtë bazë, Drejtori i Përgjithshëm i

Doganave ka nxjerrë aktin nr. 22942/1, datë 18.9.2019, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Për të gjitha veprimet e kryera në këtë rast, janë mbajtur parasysh rregullat për rastet e ristrukturimit, që parashikon ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe dispozitat e legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Pasi ka marrë emërimin e përhershëm në pozicionin *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër”* pranë DPD, rezulton se për nevoja të institucionit, me aktin nr. 6554, datë 30.3.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht për nevoja pune, në pozicionin *“Doganier, Sektori Doganor Ballsh”*, Dega Doganore Fier.

Kërkuesi ka punuar në pozicionin e mësipërm për një periudhë 3 muaj e gjysëm, pasi me aktin nr.13337, datë 15.7.2020 të drejtuesit të DPT, ai është transferuar përsëri, në mënyrë të përkohëshme, në pozicionin *“Doganier, Sektori Operacional Terminal”*, Dega Doganore Fier (ku vazhdon të punojë aktualisht).

Me pretendimin se, duke llogaritur që prej momentit të transferimit të tij të parë, në pozicionin *“Doganier, Sektori Doganor Ballsh”*, Dega Doganore Fier (datë 30.3.2020), është plotësuar afati 6-mujor i transferimit, punonjësi doganor \*\*\*\*\*, nëpërmjet një kërkesë drejtuar titullarit të institucionit, ka kërkuar kthimin e tij në pozicionin e punës *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër”*, pranë DPD ku ka emërimin e përhershëm, kërkesë të cilës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i është përgjigjur se, transferimi është kryer në zbatim të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe kërkesave specifike të Kodit Doganor në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësve doganorë dhe është brenda afateve që përcaktojnë këto akte ligjore.

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të institucionit, punonjësi në fjalë, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin e tij në vendin e punës si *“Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër”*, pranë DPD, ku ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të transferimit të përkohshëm në këtë rast, konstatohet që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Siç shihet, në gurmën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Kjo do të thotë që, një nëpunës doganor, mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme, pa patur ndonjë kufizim ligjor në shpeshësi, prandaj transferimi i përkohshëm i këtij punonjësi doganor, nga pozicioni *“Doganier, Sektori Doganor Ballsh”*, Dega Doganore Fier, në pozicionin *“Doganier, Sektori Operacional Terminal”*, po në Degën Doganore Fier, është bërë në zbatim të këtyre rregullave dhe në këto kushte, nuk mund të pranohet pretendimi se, kohët e transferimeve të përkohëshme duhet të mbliidhen dhe nëse plotësohet 6 muajshi, ai duhet të kthehet në pozicionin e tij të punës. Sipas kuptimit të dispozitave të mësipërme, në çdo rast transferimi të përkohshëm llogaritet një afat i mundshëm, deri në 6 muaj. Pra, llogaritja e afatit në rastin e transferimit të fundit, fillon nga momenti kur ai është transferuar në pozicionin *“Doganier, Sektori Operacional Terminal”*, Dega Doganore Fier (datë 15.7.2020) dhe koha e transferimit të mëparshëm nuk bashkohet me kohën e transferimit të ri.

Gjithashtu konstatohet që, aktet e transferimit janë të ligjshme, pasi kanë dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, *“Transferimi i përkohshëm”*, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për personelin e administratës doganore”*, i ndryshuar, duke i ruajtur edhe kategorinë e pagës që ka patur në pozicionin e mëparshëm (*kategoria IV-a*).

Nga sa më sipër, në analizë të fakteve dhe të akteve ligjore, arrihet në përfundimin që, transferimi i përkohshëm i punonjësit \*\*\*\*\*, në të dy rastet, është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor, por, gjithmonë duke nënvizuar se, drejtuesi i institucionit dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë rast, duhet të respektojnë kufizimet e vendosura në ligjin 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, i cili parashikon në mënyrë të shprehur se, në përfundim të afatit 6-mujor të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte i transferuar (*shkronja “c”, pika 7, e nenit 15, të Kodit Doganor*).

Në të njëjtën kohë, do të ishte e drejtë që në raste të ngjashme, nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet dhe duke respektuar parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 905 prot., datë 4.12.2020, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të tij të përkohshëm dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**